

Drejtuar: Compliance Advisor/Ombudsman
International Finance Cooperation
2121 Pennsylvania Avenue, NW
Washington, DC 20433, USA

e-mail: cao-compliance@ifc.org

ANKESË

Jemi një grup banorësh të fshatit Katund i Ri, Komuna Bradashesh, Elbasan, Shqipëri (Albania). Përmes kësaj ankese po ju drejtohem në lidhje me shqetësimin që kemi për ndotjen e ajrit në zonën tonë, të shkaktuar nga Kompania Kurum International, projekt, i cili në dijeninë tonë, financohet nga International Finance Cooperation.

Fshati ynë gjendet në një distancë prej 1 km nga Uzina e Çelikut e Kompanisë turke Kurum International, dhe për rrjedhojë ne banorët vuajmë shumë pasojat nga ndotja e ajrit e shkaktuar prej aktivitetit të kësaj kompanie.

Kjo ndotje konsiston në:

- 1- Ndotje dhe pluhur, tymrat që dalin nga oxhakët dhe pluhurat nga seleksionimi i skrapit.
- 2- Era e rëndë e squfurit, i cili përdoret si lëndë djegëse në uzinën e petëzimit të çelikut të kësaj kompanie.

Më e theksuar kjo ndotje është në orët e natës, ku një re tymi dhe erë shumë e rëndë përhapet në fshatin tonë dhe fshatrat përreth.

Ne nga ana jonë kërkojmë që ju të ndërhyni pranë kompanisë Kurum International që ta ulë në maksimum nivelin e ndotjes, të respektojë standardet, në mënyrë që ne si banorë të thithim ajër brenda parametrave të lejuar.

Në rast përgjigjeje, ju lutem nga kontaktoni në adresën e mëposhtme:

Adresa: [REDAKTUAR] Komuna Bradashesh, Elbasan, Albania

E-mail: [REDAKTUAR]

Tel: [REDAKTUAR]

Duke besuar në përgjigjen tuaj në zgjidhjen e këtij shqetësimi që kemi,

Me respekt banorët: [REDAKTUAR]